

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ**, sipas gjyqtarit Arben Hoti, me pjesëmarrjen e sek.juridike Fatmire Mani, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Imri Hashani, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit 04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë , e në bazë të neni. 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 13.11.2012 muarr:

### **A K T V E N D I M**

I pandehuri: Imri Hamit Hashani i lindur me 20.03.1968 në Prishtinë, me vendbanim në fshatin Mirashë K.Ferizajt

### **Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse deri me datën 31 mars të vitit 2012, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë në cilsinë e Këshilltarit Komunal të Komunës së Ferizajit.

- me qka ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe neni 6 par. 1 pika 1.2 të ndëshkueshme me nenin 17 par.1 pika 1.2 të Ligjit Nr.04/L-050.
- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore, e në vështrim të nenit 9 të LK.

### **D E N O H E T**

**ME DENIM NË GJOBË** në shumë prej 400 €,

Dënimin e shqiptuar në të holla ka për ta paguar në afatin prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën do ti zavendësohet në dënim burgu në kohëzgjatje prej 26 ditësh.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore, të paguaj shumën paushale prej 5.- € .në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Nga një ekzemplarë të këtij aktvendimi iu dërgohet palëve dhe ushtruesit të kërkesës.

### **A r s y e t i m**

Agjencia Kundër Korrupsionit e Republikës së Kosovës ,ushtroj kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-2211/2012 kundër të pandehurit Imri Hashani për shkak të kundërvajtjes mos deklarim i pasurisë me kërkesë të Agjencisë të zyrtarit të lartë publik, nga neni 5. 6 pika 1.3 dhe 9 të ligjit 04/L-050, duke kërkuar që të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari filloj procedurën kundërvajtëse, analizoj provat që gjinden në shkresat e lëndës, mori në pyetje të pandehurin si dhe dëshmitarët.

I pandehuri në deklaratën e tij theksoi se nuk ka qenë i informuar dhe nuk i ka pranuar formularët për plotësim, dhe shton se për këtë gjë është informuar nga mjetet e informimit, dhe se po të ishte në njohuri për një obligim të tillë ligjor ai do ta plotësonte formularin, pasi që nuk ka qfarë të fshehtë.

Dëshmitari Naser Musa në dëshminë e tij në cilsinë e Zyrtaarit Të Pikës Kontaktuse të Komunës së Ferizajit ka theksuar se materialet bashkë me formularët të cilat i ka pranuar nga Agjencia ju kanë shpërndarë këshilltarëve të komunës në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Ferizajit të datës 09.03.2012, si dhe nga foltorja e kuvendit janë njoftuar edhe gojarisht nga

DPK/DMP  
02

03-4383/12  
07.12.2012

kryesusi i asamblesë në atë kohë Agim Aliu, për qka prezentoj para gjykatës regjistrin e anëtarëve pjesmarrës. Nga deklarata e këtij dëshmitari gjyqtari e vërtetoi faktin se i pandehuri Imri Hashani ka prezentuar në këtë mbledhje dhe ka vendosur nënshkrimin në këtë regjistër.

Dëshmitarit Afrim Matoshi në cilësinë e Zyrtarit Për Mbarvajtje të Kuvendit Komunal të Ferizajit në deklaratën e tij ka theksuar, se pasi ka marrë formularët nga Zyrtari i Pikës Kontaktuse Naser Musa të njejtat në mbledhjen e 09.03.2012 i ka shpërnda në ulëset me emër dhe mbiemër të secilit këshilltar veç e veç, duke shtuar se edhe Kryesusi i Asamblese i ka njoftuar gojarisht nga foltorja. Nga deklarata e këtij dëshmitari gjyqtari e vërtetoi faktin se të pandehurit i është dorzuar materiali në ulësen e tij në kuvend, dhe se është informuar edhe gojarisht nga kryesusi pasi që ka prezentuar në këtë mbledhje.

Gjatë caktimit të dënimit u muarrën parasyshtë të gjitha rrethanat si gjendja ekonomike e të pandehurit, dhe rrethanat e parapara me nenin 9 të LK, dhe u konstatua se në rastin konkret me kundërvajtje nuk janë shkaktuar pasoja të rënda, ndërsa ekzistojnë rrethana lehtësuese që vëjnë në dukje se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjyqtari në këtë qështje kundërvajtëse aplikoi dispozitat e nenit 5 dhe nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 dhe dispozitën ndëshkimore të paraparë me nenin 17 par.1 pika 1.2 të ligjit Nr.04/L-050, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me raportim të rregullt vjetor.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë **Gjykatës së Lartë Për Kundërvajtje në Prishtinë** brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi përmes kësaj Gjykate pa pagesë takse.

Vendosur në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj.

Sek.juridike  
Fatmire Mani-Haxhijaj

